



FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE

në bashkëpunim me

Fakultetin e Informatikës, Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore

ORGANIZON

Konferencën e IV-të Shkencore Studentore me temë

“Nga Auditori në Tregun Dixhital: Strategjitë e Studentëve për Zhvillimin e Aftësive të Reja në Epokën e Inteligjencës Artificiale”

29 prill 2026 Tiranë, Shqipëri

THIRRJE PËR PUNIME

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë ka kënaqësinë t’ju njoftojë organizimin e Konferencës së IV-të Shkencore Studentore në bashkëpunim me Fakultetin e Informatikës, Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore.

Ky event synon të krijojë një traditë të pjesëmarrjes së studentëve të nivelit Bachelor dhe Master në një proces të thellimit të punës së tyre kërkimore shkencore si dhe të shërbejë si një platformë që do t’iu mundësojë studentëve prezantimin e punës së tyre, shkëmbimin e mendimit kritik dhe angazhimin në një praktikë dialoguese me studentë të të gjitha fushave të studimeve juridike, sociale, informatike, mjekësore dhe ekonomike.

Konferenca synon të bashkojë në një tryezë debati studentët e të gjitha degëve dhe programeve të studimit të ofruara nga fakultetet dhe departamentet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë si dhe studentë nga Universitete të tjera në vend për shkëmbimin e ideve dhe zhvillimin e punës së tyre kërkimore shkencore në lidhje me të gjitha aspektet e fushave ndërdisiplinare si studimeve në fushën e së drejtës, shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare, studimeve rajonale,

studimeve antropologjike, studimeve psikologjike, studimeve të komunikimit, studimeve të fushës së edukimit, studimeve të fushës ekonomike, informatike, mjekësore.

Konferenca do të shërbejë për të gjithë pjesëmarrësit si një platformë për ndërlidhje, shkëmbim idesh dhe ballafaqim të punës së tyre kërkimore e cila është në fazat e para, me një komunitet akademik të specializuar. Konferenca nxit debatin për zhvillimet aktuale, ide, qasje dhe teori të reja, shqetësime dhe sfida në fushën e drejtësisë, studimeve sociale, studimeve në fushën informatike, ekonomike dhe mjekësore.

Tematikat

Studentët sugjerohen të trajtojnë procesin e ndikimit të zhvillimit të inteligjencës artificiale ndaj shoqërisë në përgjithësi duke pasë mundësi të thellohen në punimet e tyre në drejtime specifike të ndikimit që sjellin këto ndryshime për të ardhmen e punës dhe Tregun Dixhital në kushtet aktuale të zhvillimit të inteligjencës artificiale si më poshtë:

1. Zhvillimi teknologjik: Rreziqe dhe mundësi për shoqërinë.
2. Teknologjia dhe transformimi i shoqërisë: Sfidat e të ardhmes.
3. Sfidat e të rinjve dhe perspektivat në shoqërinë në zhvillim.
4. Drejt një shoqërie inteligjente: Sfidat dhe e ardhmja e punës.
5. IA si Partner, jo si Zëvendësues: Si po ndikon Inteligenca Artificiale në profesionet tuaja të ardhshme (Mjekësi, Drejtësi, Ekonomi, Informatikë, Shkenca sociale etj.).
6. Analizë mbi atë që ofron auditori përkundrejt kërkesave teknike të tregut sot.
7. Vetë-edukimi në Epokën Dixhitale: Roli i kurseve online, mikrokredencialeve dhe certifikimeve në ndërtimin e një karriere globale.
8. Arsytet se pse kreativiteti, mendimi kritik dhe etika janë më të rëndësishme se kurrë në një botë të automatizuar.
9. Strategjitë e studentëve për punësimin në kushtet e një ekonomie të re dhe punën në distancë gjatë studimeve.

Data të rëndësishme:

Afati përfundimtar i dorëzimit të abstrakteve	28 mars 2026
Njoftimi i pranimit të abstrakteve	10 prill 2026
Dita e Konferencës	29 prill 2026
Punimi i plotë	20 maj 2026

Abstrakti dhe Punimi:

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur të dërgojnë abstraktet e punimeve, që duhet të përmbajë: Emrin e autorit/rëve, institucionin, Fakultetin, programin e studimit, vitin e studimit, adresën elektronike, (200-250 fjalë, Times Neë Roman, 12, single spaced) deri në datën **28 mars**. Materialet do të dërgohen në adresën **ambra.kallari@umsh.edu.al**

Teksti i plotë i punimit duhet të përmbajë 5000 – 7000 fjalë, i shkruar në Times Neë Roman, size 12, singled spaced dhe të përmbajë: Emrin e autorit/rëve, institucionin, adresën elektronike, Abstraktin, Fjalët kyçe, Hyrjen, Pjesën kryesore, Përfundimet dhe Bibliografinë. Afati përfundimtar i dërgimit të tekstit të plotë të artikullit është data **20 maj 2026**.

Abstraktet e punimeve të përzgjedhur nga Komiteti Shkencor, do të botohen në Proceedings të Konferencës që do të jetë në format elektronik. Të gjithë pjesëmarrësit do të marrin një kopje elektronike të Proceedings të Konferencës

Punimet më të mira të përzgjedhura nga Komiteti Shkencor, do të kenë mundësinë të botohen në një numër special të Revistës Shkencore të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, POLITEIA.

Të gjithë pjesëmarrësit në Konferencë do të pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje.